Permbledhje Jo-Teknike

CAPITAL GROUP sh.p.k

3/1/2021

User

a. Profili i subjektit "CAPITAL GROUP" sh.p.k.

Subjekti "CAPITAL GROUP" sh.p.k. është themeluar më datë 06.01.2016 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 13.01.2016, me Nr. L62513212V NIPT**.** Objekti ku janë instaluar linjat teknologjike për prodhimin e detergjentëve pluhur dhe të lëngshm, është pjesë e ish-godinave të Kombinatit të Nikelit dhe Kobaltit i cili është rikonstruktuar pothuajse tërësisht për t'u përshtatur me veprimtarinë që do të kryhet. Hapësirat e brendëshme të objektit dhe ato jashtë tij, janë të mjaftueshme për zhvillimin normal të proçeseve teknologjike, magazinimin e lëndëve të para dhe të produkteve si dhe për qarkullimin e lirë të mjeteve të transportit dhe personelit punonjës.

Sipas ekstraktit të Q.K.B-së, objekti i aktivitetit të këtij subjekti është (citojmë): *Prodhim, magazinim dhe tregtim të detergjentëve të të gjitha llojeve për larje dhe pastrim përdorim shtëpiak dhe industrial. Prerje, stampim dhe palosje të letrës dhe kartonit për amballazh, qese letre, kartëpiceta, letër higjenike dhe paketimi. Prodhim të amballazheve prej letre dhe kartoni të të gjitha llojeve me lëndë të parë të gatshme për mallrat ushqimore dhe industriale. Paketim të mallrave ushqimore dhe industriale. Transport të mallrave. Tregtimi me shumicë dhe pakicë dhe import-eksport të mallrave të ndryshëm industriale, ushqimore, pije, konfeksione, hidrosanitare, hidraulike, mobilje e orendi shtëpiake, elektroshtepiake, kinkaleri e kancelari zyre dhe shkollore, pajisje elektrike dhe elektronike, makineri, pjesë këmbimi për auto, bateri, goma.*

Zhvillim të aktivitetit tregtar në dyqane dhe markete. Import-eksport sipas legjislacionit Shqipëtar. Shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare. Dezinsektim, deratizim, dezinsektim.

Administrator i subjektit është z. Blendi Çala, për periudhën 14.01.2021 deri 14.01.2026.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të prodhojë produktet dhe nënproduktet e detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm, për përballimin e kërkesave të sektorit familjar dhe bizneseve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

b. Shpjegime rreth termave të përdorura.

Shpjegimi rreth termave të përdorura në këtë dokument është bërë bazuar në Nenin nr.2. Përkufizime, të Ligjit Nr. 10 216, datë 21.01.2010 "PËR DETERGJENTËT".

"Detergjent" është çdo substancë ose preparat, në formë të lëngët, pluhuri, paste, kallëpi,

blloku, figure etj., që përmban sapune dhe/ose lëndë të tjera tensioaktive, i destinuar për t'u përdorur në proçeset e larjes dhe të pastrimit, si dhe tregtohen dhe/ose përdoren për qëllime shtëpiake ose industriale.

Detergjentë vlerësohen edhe produktet e mëposhtme:

"Preparat ndihmës për larje", i përcaktuar për njomje (paralarje), shpëlarje ose zbardhje

rrobash, tekstilesh për përdorim shtëpiak, etj.;

"Zbutës tekstilesh", i përcaktuar për të ndryshuar karakteristikat në prekje të tekstileve, në proçeset që plotësojnë larjen e tyre;

"Preparat pastrimi", i përcaktuar për pastruesit shtëpiakë, universalë dhe/ose pastrime të tjera sipërfaqesh.

"Larje" është pastrimi i rrobave, tekstileve, enëve dhe sipërfaqe të tjera të forta.

"Pastrim" është largimi i një depozitimi të padëshirueshëm mbi dhe/ose në brendësi të substratit, që ndryshon disa karakteristika, pamjen ose ndjesinë e një sipërfaqeje të pastër.

"Substanca" janë elementët kimike dhe përbërjet e tyre siç gjenden në natyrë ose të përftuara nga çdo proçes prodhimi, përfshirë çdo shtesë të nevojshme për të ruajtur stabilitetin e produkteve dhe çdo papastërti, si pasojë e proçesit të përdorur, por duke përjashtuar çdo tretës, i cili mund të ndahet nga substanca, pa ndikuar në stabilitetin e saj ose pa ndryshuar përbërjen e saj.

"Preparat" është përzierja ose tretësira, e përbërë nga dy ose më shumë substanca.

"Lëndë tensioaktive" është çdo substancë organike dhe/ose preparat, i përdorur në detergjentë, i cili vepron në sipërfaqe dhe përbëhet nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe një a më shumë grupe hidrofobe, të një natyre dhe me përmasa të tilla, që i japin aftësinë të zvogëlojë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër, të formojë emulsione dhe/ose mikroemulsione dhe/ose micela dhe të thithë në sipërfaqet e kontaktit ujë-trup i ngurtë.

"Biodegradim" është një proces, prej të cilit përbërjet kimike organike (përbërjet që përmbajnë karbon) zbërthehen në përbërje më të thjeshta kimike nën veprimin e mikroorganizmave në natyrë.

"Vendosje në treg" është bërja e disponueshme në treg e detergjentëve dhe e lëndëve tensioaktive për detergjentët për palët e treta, kundrejt pagesës ose falas. Importimi vlerësohet, gjithashtu, vendosje në treg.

"Fabrikues" është çdo person fizik ose juridik, përgjegjës për vendosjen në treg të detergjentëve ose të lëndëve tensioaktive për detergjentët. Gjithashtu, vlerësohet fabrikues përfaqësuesi i tij i autorizuar, prodhuesi, importuesi, paketuesi që punon për llogari të tij ose çdo person, që ndryshon karakteristikat e detergjentit a të lëndës tensioaktive të detergjentit, që krijon ose ndryshon etiketimin e tij, kur vetë fabrikuesi nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe shpërndarësi kur vepron si importues.

"Detergjent industrial" është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.

2.2. Përshkrimi i vendndodhjes.

Kompleksi i ish-Kombinatit Metalurgjik, këto 20-30 vitet e fundit po transfromohet në një zonë të zhvilluar industriale, duke shfrytëzuar infrastrukturën inxhinjerike egzistuese si dhe duke kryer investime të rëndësishme në instalimin e teknologjive të reja prodhuese.

Subjekti “CAPITAL GROUP” sh.p.k. ka disa vite që ka përshtatur një nga ndërtesat e ish-kombinatit të Nikelit dhe Kobaltit, dhe ushtron veprimtarinë në prodhimin, magazinimin dhe tregtimin e detergjentëve të të gjitha llojeve për larje dhe pastrim përdorim shtëpiak dhe industrial.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e prodhimit të detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm të shoqërisë “CAPITAL GROUP” sh.p.k. është i vendosur në anën e majtë të rrugës automobilistike të ish-kombintait, duke lëvizur nga hyrja e tij në brendësi.

Subjekti ka kryer investime në rikonstruksionin apo mirëmbajtjen e godinave, rrjeteve inxhinjerike, instalimin e makinerive e paisjeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë.

Objekti është lidhur në mënyrë organike me rrjete inxhinjerike të kësaj zone industriale, në bazë të kontratave respektive me subjektet që administrojnë këto rrjete.

- *Furnizimi me energji elektrike*

Subjekti furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni elektrik i ish-uzinës 12. Rryma elektrike merret nga rrjeti nëntoksor me kabëll të përshtatshëm për rrymë dy dhe tre fazore. Brenda reparteve prodhuese janë ndërtuar rrjetet e brendëshme përkatëse për shpërndarjen e rrymës tre fazore në të gjitha makineritë dhe pajisjet e instaluara aty.

Po kështu është edhe rrjeti i brendëshm i rrymës dy fazore e cila përdoret kryesisht për sistemet e ndriçimit të ambjenteve të punës, zyrave e pajisjeve të tyre, etj.

Të dy këto rrjete kanë pajisjet e duhura teknike të vënies në punë dhe të ndalimit të makinerive, pajisjet e mbrojtjes nga mbingarkesat e rrymës dhe të tensionit, lidhjeve tokëzuese, etj.

Subjekti ka të instaluar pajisje elektrike me fuqi që shkon në nivelet e 300 kWh.

- *Furnizimi me ujë.*

Subjekti “CAPITAL GROUP” sh.p.k. furnizohet me ujë të pijshëm dhe ujë industrial, nga rrjetet përkatëse të ish-kombinatit metalurgjik.

Brenda objektit ka një rrjet të brendëshëm të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe atij industrial në të gjitha pikat konsumatore të tij.

Uji industrial nuk është pjesëmarrës në asnjë prej proçeseve teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari. Ai përdoret kryesisht për përdorim në ambjentet hidro-sanitare si dhe për pastrimin/larjen e ambjenteve të punës.

Sasia mesatare e përdorimit të ujit është rreth 200. m^3/muaj.

- *Furnizimi dhe konsumi i lëndëve djegëse.*

Për plotësimin e kërkesave të zhvillimit normal të kësaj veprimtarie, subjekti konsumon disa lloje lëndësh djegëse si :

- GLN (propan + butan).

GLN përdoret për ngrohje gjatë stinës së ftohtë të vitit. Në hapësirat punuese të objektit, janë vendosur disa soba ngrohëse të cilat përdorin GLN.

Ai vjen në subjekt i ambalazhuar në bombulat përkatëse. Konsumimi i GLN-së është relativisht më i madh gjatë stinës së ftohtë të vitit. Mesatarish konsumi i tij shkon në 150 litra/muaj.

- Karburante (naftë & benzinë).

Nafta dhe benzina përdoren nga mjetet e transportit që zotëron subjekti. Këto mjete transporti përdoren për transportin e lëndëve të para dhe të atye ndihmëse, për transportin e prodhimeve të realizuar si dhe për transportin e punonjësve.

Subjekti zotëron dhe shfrytëzon edhe disa mjete ngritëse e transportuese të cilat përdoren për transportet e materialeve të ndryshme, me pesha relativisht të mëdha brenda objektit. Në subjekt funksionojnë edhe autovetura e fugonë për transportin e personelit.

Sasitë e konsumit të naftës dhe benzinës shkojnë në nivelet e .100. litra/muaj.

Nafta dhe benzina blihen në pikën më të afërt të tregtimit të tyre në bazë të kontratës përkatëse me subjektin që administron këtë pikë karburanti.

2.3. Përshkrimi i veprimtarisë.

Forma e lëngët për detergjentët shtëpiak po fiton gjithnjë e mëshumë pjesë të tregut në shumë vende botërore veçanërisht, detergjentët për larjen e enëve dhe format e lehta të tyre. Produktet e kujdesit personal në formë të lëngshme zënë një pjesë të konsiderueshme të tregut dhe mund të prodhohen në të njëjtat impiante si detergjentët e lëngshëm. Për këtë arsye, sa herë që u referohemi detergjenteve të lëngshëm, mund t'u referohemi edhe produkteve të kujdesit personal.

Pavarësisht nga lloji i detergjentëve që synohen për t'u realizuar, prodhimi i detergjentëve në përgjithësi bazohet në proçese teknologjike, pajisje dhe makineri si dhe përdorim të lëndëve të para dhe ndihmëse, në përputhje me kërkesat kimike dhe fizike që duhet të plotësojnë këto produkte.

Detergjenti i prodhuar, në të cilin janë përfshirë përbërës të ndryshëm duhet të jetë i qëndrueshëm. Ky rezultat arrihet kur të gjithë përbërësit e formulimit (lëndëve të para dhe ndihmëse, pajisjet dhe parametrat teknologjikë). zgjidhen siç duhet dhe futja e tyre në recetën e produktit është e tillë që

të shmanget një ndryshim i fortë i temperaturës, pH dhe viskozitetit, si dhe reaksioneve kimike të padëshirueshme.

Me fjalë të tjera, prodhimi i llojeve të përcaktuara të detergjentëve kërkon kujdes të madh në përcaktimin dhe formimin e "përzjerjeve" të qëndrueshëm të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse si dhe të shpërndarjes uniforme në produktin e kërkuar. Kjo zakonisht perceptohet si "homogjeniteti i produktit".

Kërkesat teknike dhe ato tregtare, që kushtëzojnë produktet e detergjentëve, pavarësisht nga fushta e përdorimit të tyre dhe/ose përdorimi specifik, mund të përmblidhet si më poshtë:

- Pamja e bukur (ngjyra dhe shkalla e transparencës);
- Viskoziteti i kontrolluar;
- Stabiliteti kundrejt kohës së ruajtjes, temperaturës dhe efekteve të dritës;
- Paketimi i përshtatshëm dhe tërheqës është gjithashtu i një rëndësie të madhe.

Prodhimi i detergjentëve të llojeve të ndryshëm, mbështetet në një njohuri të mirë të treguesve fiziko-kimikë të përbërësve të detergjentit dhe aftësisë për të kontrolluar dhe modifikuar ndërveprimet e tyre, gjatë zhvillimit të proçeseve teknologjike respektive.
Impianti i prodhimit të detergjentëve pluhur dhe të lëngshëm funksionon mbi bazën e një proçesi të thjeshë fiziko-kimik, i cili bën të mundur që lënda e parë agregate e detergjentëve, e cila vjen nga kompani të liçencuara dhe ka përmasa të kokrrizave të vogla dhe produkte të lëngëshme, i nënshtrohet proçeseve fiziko-kimike në linjën e prodhimit të detergjenteve, duke përftuar në këtë mënyrë produktin e dëshiruar për tregun rajonal.
Prodhimi i të gjitha llojeve të detergjenteve përfshin hapat e treguar në këtë skemë:

- Mundësia për të përpunuar lëngje në një gamë të gjerë viskoziteti (5 deri 6000 mPa.sec);
- Mundësia e përdorimit të tretësve alkoolikë (domosdoshmëria e modelit anti-shpërthim);
- Bashkim i lehtë me një sistem të kompjuterizuar të kontrollit të procesit;
- Përdorimi i materialeve me rezistencë të lartë dhe korrozioni (çelik inox dhe lidhje të veçanta);
- Aftësia për të siguruar shpejtësi të lartë të transferimit të nxehtësisë (si për ftohjen ashtu edhe për ngrohjen);
- Aftësia për të siguruar përzierje intime dhe të vazhdueshme;
- Mundësia për të korrigjuar pH, viskozitet dhe temperaturë (nga pajisje specifike);
- Mundësia e pastrimit të shpejtë dhe të thjeshtë (për të zvogëluar ndryshimin e produktit me kalimin e kohës) pa rrezik të ndotjes

Hapat që ndiqen në impiantin e prodhimit të detergjenteve janë:
Në fillim hidhet ujë dhe pastaj sipas radhës hidhen lëndët e para duke vazhduar pandërprerë përzjrjen deri në krijimin e një mase uniforme. Në vijim bëjmë analizën kimike përkatëse për vizkozitetin dhe ph dhe, në bazë të rezultatit të saj, bëjmë ose jo korigjimet e duhura.
Në vartësi të produktit që kërkohet të realizohet, në vend të ujit, në vifillim hidhet një tretësirë 3 % me NaOH. Në vartësi të përbërjes kimike të ujit (fortësisë së tij ose përmbajtjes së klorit, etj.), llogaritet sasia e produktit që do të realizojmë si dhe sasia e ujit plus hipo plus NaOH. E gjithë kjo tretësisrë i nështrohet më tej përzjerjes së bashku me lëndët e para dhe ato ndihmëse, që marrin pjesë në krijimin e produktit përkatës.

SKEMA TEKNOLOGJIKE PRINCIPALE.



Në përgjithësi, proçesi i prodhimit është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik **i** linjës së prodhimit të detergjenteve.
Për menaxhimin e materialeve pjesmarrës në proçeset teknologjike dhe funksionimin e linjës së prodhimit të detergjentëve në një ditë të zakonëshme pune, skema e funksionimit është relativisht e thjeshtë dhe e mirëorganizuar nga drejtuesi ligjor i këtij subjekti.

Drejtuesit teknik menaxhojnë të gjithë operacionet e punës së impiantit të podhimit të detergjenteve, duke filluar nga regjistrimi i urdhërave të përditshëm, listën e kërkesave, llogaritjet teknologjike të prodhimit që kërkohet të realizohet, në përputhje me llojet dhe sasitë e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që duhet të përdoren, menaxhon kohët e dorëzimit dhe të shkarkimit, kontrollon dhe përmirëson gabimet e mundëshme të identifikluar gjatë zhvillimit të proçesit të prodhimit duke përdorur metodikat e miratura për çdo rast.

Drejtuesit teknikë të prodhimit bëjnë:

- Kontrollin në kohë reale të ecurisë së parametrave teknikë të prodhimit dhe paraqitjen në grafikë visual, të prodhimit orar.
- **K**ontrollin dhe koordinimin e plotë të të gjithë operacioneve teknologjike të prodhimit si psh dozimin në lloje dhe peshë të materialeve dhe energjive si dhe, ofrojnë informacione të vazhdueshme të konsumit të tyre.
- Ndjekin dhe drejtojnë një gamë të gjërë të programeve të prodhimit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:

i. Menaxhimit të Porosive, nëpërmjet:

- Administrimin e dokumenteve të proçesit të ngarkimit të impiantit;
- Administrimin e dokumenteve të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual.
- Menaxhimit të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse, hyrje ose dalje, gjendje në proçes etj.
- Menaxhimit të përditshëm të prodhimit të realizuar, në sasi idhe lloje.
- Kontrollit të parametrave të shfrytëzimit notmal të aftësive të linjës së prodhimit.
- Zbatimit të programeve të kontrolleve teknike dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të linjës teknologjike.

ii. Menaxhimit të Panelit të Kontrollit, nëpërmjet kontrollit dhe ndërhyrjes:

- Automatike për të balancuar sasinë e ujit në vartësi të përmbajtjes së lagështisë të materialeve që marrin pesë në proçes.
- lPërcjell/dërgon lëndë të para/ndihmëse alternativë për përdorim, në rastet e mungesës, apo pamjaftueshmërisë së tyre për një process të caktuar.
- Menaxhon operacionet e ngarkimit në përzjerës, për çdo lëndë përbërëse, duke rregulluar rrugën hyrëse të materialeve, kohën e përzierjes dhe të shkarkimit.
- Kontrollon kohën reale për çdo fazë të funksionimit të proçesit teknologjik si dhe, optimizon kohët e prodhimit, konsumit të energjisë dhe të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse.

- Kontrollon rezervat materiale dhe njofton për çdo rast kur gjendja e tyre është në kufinjët e përcaktuar.

Punonjësit.

- Kryejnë operacionet e ngarkim-shkarkimit të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse etj.
- Kontrollojnë, mirëmbajnë dhe kryejnë riparimet e mundëshme të pajisjeve të linjës teknologjike, aparaturave etj.
- Bëjnë rakordimin e sasisë së materialit të shkarkuar dhe produktit përfundimtar.
- Bëjnë transportimin dhe magazinimin e produkteve të realizuara dhe të ambalazhuara.
- Bëjnë pastrimin e pajisjeve, të vendit të punës etj. në përfundim të ditës së punës.

Produktet kryesore të prodhimit të detergjenteve.

Në linjat teknologjike të këtij subjekti realizohet prodhimi i këtyre detergjentëve. Çdo njëri prej tyre ka përbërje cilësore të përcaktuar, e përcaktuar kjo nga:

- Qëllimi për të cilin është realizuar çdo produkt;
- Lëndët e para dhe ato ndihmëse që kanë marrë pjesë në formimin e tij;
- Trajtimi fizik-kimik (parametrat teknologjikë) të cilit i janë nështruar lëndët e para dhe ato ndihmëse.

Nga ky subjekt në impiantin e prodhimit të detergjentëve, përftohen këto produkte: zbutës rrobash, pastrues dyshemeje, pastrues xhamash, larës enësh, sapun i lëngshëm, zbardhues, etj.

Lëngjet	Kapacitetet Pergatitje	Prodhimi mujor		
		Sasia	Pergatitje	Mbushje
	kg/d	ton	p*d	p*d
Zbutës rrobash	3000	80	53	83
Pastrues dyshemeje	2000	25	25	26
Pastrues xhamash	3000	5	3	5
Larës enësh	1000	3	6	3
Sapun i lëngshëm	1000	1	2	1
Zbardhues.	4200	30	7	31

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar për të operuar dhe për të zhvilluar aktivitetin e prodhimit të detergjenteve pluhur dhe të lëngshëm, me të cilët ky subjekt është i pranishëm në tregun rajonal.

Drejtuesit administrative dhe ata teknikë të prodhimit, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit prodhues, kujedsen të zbatohen të gjitha rregullat teknike, të shfrytëzimit të makinerive dhe linjave teknologjike si dhe kartët teknolgjike të pregatitjes së llojeve të caktuara të detergjentëve të lëngët apo plohur. Njëkohësisht ata kërkojnë edhe zbatimin korrekt të rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, mbrojtjes së mjedisit etj.

Në këtë veprimtari, veprimtaria prodhuese është e organizuar në menyre të tillë që, të funksionojë në formën e një organograme për realizimin sa më efiçent dhe të sukseshëm, duke treguar mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të secilit.

Përbërësit kryesorë të programit për menaxhimin e instalimit, me synim mbrojtjen e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Respektimi i orareve të punës për të gjithë punonjësit e kësaj veprimtarije.
- Zbatimi me korrektësi i rregullores së brendëshme si dhe të rregulloreve teknike.
- Vendosja një zinxhiri për përgjegjësitë dhe vendimmarrjet.
- Vlerësimi i informacionit të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsyet për një menaxhim mjedisor të qëndrueshëm dhe të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të Çertifikuara sipas Standarteve Europiane si dhe kontrolli teknik dhe kolaudimi periodik i tyre nga subjekte ekspertë liçensuar.
- Mirëadministrimi i ndikimeve potenciale ambientale, që mund të identifikohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara si dhe krijimi i marëdhënieve kontraktore me kompani të liçensuara për rekuperimin/riciklimin/ripërdorimin apo asgjësimin e tyre.
- Trajtim i ujrave teknologjike të gjeneruara nga kjo veprimtari.
- Identifikimi dhe vlerësimi i zhurmave dhe vibrime të çfaqur gjatë zhvillimit të aktiviteteve prodhuese.
- Propozimi dhe zbatimi i masave zbutese, të ndikimeve në mjedis.
- Monitorimi i cilesise ajrit, i cilësisë së ujrave të shkarkuar, nivelit të zhurmës etj.
- Kryerja e trajnime specifike, për personelin punonjës.

Legjislacioni shqiptar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, parashikon përfshirjen e stafit drejtues teknik dhe administrativ, në proçesin e identifikimit të rreziqeve të mundëshme në vendet e punës gjatë zhvillimit të veprimtarisë së çdo subjekti fizik dhe juridik, me qëllim shmangien apo/ose parandalimin e zhvillimit të tyre. Është detyrim ligjor për çdo subjekt fizik/juridik, hartimi dhe zbatimi i rregulloreve të mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe njohja e gjithë personelit punonjës të subjektit me këto rregullore duke bërë kështu që, punëtorët të kenë një rol thelbësor në parandalimin e rreziqeve si dhe në zgjedhjen dhe zbatimin e masave specifike për çdo tipologji proçesi pune.

Drejtuesit teknik dhe administrativë të subjektit duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe pa kompromis për ndërgjegjësimin e punonjësve të tyre në njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurisë në punë, si dhe në azhornimin e përhershmë me zhvillimin e legjislacionit përkatës.

Po kaq e rëndësishme është edhe bashkëpunimi me institucionet ligjore përkatëse të kësaj fushe si dhe, me subjekte e shoqata që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë.

Aksidentet në punë në shumicën e rasteve ndodhin, për shkaqe subjektive të lidhura me moszbatimin e rregullave teknike të shfrytëzimit të makinerive dhe pajisjeve si dhe të mos zbatimit të rregullave të mbrotjes dhe sigurisë në punë, mbrojtjes nga zjarri etj.

Ky mos zbatim i rregullave të përcaktuara është i lidhur shpesh edhe me njohuritë e limituara që kanë punëtorët e pakualifikuar apo të pa trajnuar, në lidhje me proçeset e punës, makineritë dhe pajisjet që ato përdorin etj.

Me termin **"veçantitë e punës",** duhet të kuptojmë njohuritë specifike që sipërmarrësi (pronari) duhet të ketë, në lidhje me aktivitetin që ai ka ndërmarrë, duke përgatitur në këtë mënyrë mjedisin e punës, duke blerë pajisjet e nevojshme dhe duke përzgjedhur bashkëpunëtorët në mënyrën që të optimizojë rezultatin e prodhimit, por edhe të sigurojë kushtet më optimale të mundëshme të mbrojtjes dhe sigurisë në punë të punëtorëve dhe të të gjithë atyre që mund të pësojnë dëmtime nga puna e ushtruar në kompaninë/subjektin e tij.

Me termin **"përvojë/eksperiencë punë"** duhet të kuptojmë vëmendjen nga ana e sipërmarrësit dhe bashkëpunëtorëve të tij, për vlerësimin, analizimin dhe nxjerrjen e përfundimeve mbi ngjarjet që ndodhin gjatë proçesit të punës në atë subjekt apo sektorë të veçantë të tij, duke ju referuar veçanërisht aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Me termin **"teknikë",** do të thotë se punëdhënësi dhe ndihmësit e tij, me kujdes, zell dhe aftësi, përveç miratimit të çdo mase paraprake për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen në punë të punëtorëve, ndjekin edhe evolucionin tekniko-shkencor të sektorit, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen në punë, mbrojtjen nga zjarri si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë kësaj periudhe të shfrytëzimit të kësaj kariere, në këtë subjekt është krijuar një eksperienca e mjaftueshme nga punojësit e tij, për zhvillimin normal të proçeseve të punës. Janë bërë përpjektet e duhura për :

- Vlerësimin e rreziqeve të mundëshme të cilët cënojnë sigurinë dhe mbrotjen në punë.
- Hartimin e rregullore të shfrytëzimit të makinerive teknologjike.
- Hartimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Përcaktimin e planit të veprimit në rastet e emergjencave.

Vlerësimi i rreziqeve të mundëshme.

Vlerësimi i rreziqeve të mundëshme, të cilët cënojnë sigurinë dhe mbrotjen në punë, është një proçes planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe riekzamini të rreziqeve të pranishme gjatë zhvillimit të proçeseve të punës.

Ky proçes, i lejon punëdhënësit (pronarit apo/ose admnistratorit të subjektit) të marrë masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e punëtorëve dhe personave të tjerë të pranishëm në vendin e punës.



Në këtë proçes përfshihen:

- parandalimi i rrisqeve të mundëshme të aksidenteve në punë;
- informimi i punëtorëve dhe i personave të pranishëm në subjekt;
- trajnimi i punëtorëve;
- parametrat teknik dhe organizativ, që duhen respektuar për marjen e masave të nevojshme;

Aksidentet në pjesën më të madhe të tyre, ndodhin për shkak të mos zbatimit korrek të rregullave të vënies në punë dhe të ndalimit të makinerive e pajisjeve. Ky mos zbatim i rregullave të përcaktuara është i lidhur shpesh edhe me njohuritë e limituara që kanë punëtorët e pakualifikuar apo të pa trajnuar, në lidhje me proçeset e punës, makineritë dhe pajisjet që ato përdorin etj.

Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë kryesisht me shkaqe subjektive, të krijuara nga vetë punonjësit. Në këtë subjekt, egziston një eksperiencë e mirë, në trajtimin e aksidenteve dhe kjo dëshmohet në numurin mjaft të kufizuar të ndodhjes së tyre gjatë kësaj periudhe relativisht të gjatë pune.

Këtu gjenden rregullore të shfrytëzimit të linjave teknologjike, të rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë, të mbrojtjes nga zjarri si dhe të trajtimit të emergjencave të ndryshme.

I. Analiza dhe vlerësimi I rriskut.

Duke analizuar punën disa vjeçare të linjës teknologjike të prodhimit të betonit dhe elementëve të tij si dhe, përpunimit të inerteve rezultojnë të dhëna se mund të bëjmë një klasifikim të mundësisë së rriskut dhe ndodhjes së aksidenteve për çdo njerën prej tyre.

Sejcila prej linjave teknologjike të sipërpërmendura mbart rrisqe të caktuar lidhur me sigurinë dhe mbrotjen në punë, mbrojtjen e mjedisit apo ndikimeve të saj në cilësinë e mjedisit si dhe të mbrojtjes nga zjarri.

Punëdhënësit e subjekteve edhe në rastin kur në subjektin e tyre punojnë edhe më pak se 10 punonjës, duhet të vëzhgojnë masat e përgjithshme të përcaktuar nga vetë ato në "*Masat për përmirësimin e sigurisë në punë".*

Ato duhet të kujdesen për mbajtjen e objektit ku zhvillojnë veprimtarinë në kushte teknike të rregullta si dhe në kushte shëndetësore të shëndetshme.

Vlerësimi i rrezikut/qeve mundëson që punëdhënësi të zbatojë programe specifike të cilat janë të domosdoshëm për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve.

Punëdhënësi/administratori i zbaton masat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës mbi bazë të parimeve themelore të pasqyruara në vijim:

- Vlerësimin e rreziqeve të mundëshme;
- Hartimin dhe zbatimin e programe për shmangien/eleminimin e rreziqeve të cilët nuk mund të shmangen;
- Përshtatjen e punës ndaj individit veçanërisht sa u përket karakteristikave të vendit të punës dhe mjedisit të punës;
- Zgjedhjen e pajisjeve për mbrojtje personale dhe kolektive;
- Hartimin e programeve të zhvillimit dhe përmirësimit të teknologjisë, pajisjeve e makinerive me synim zëvëndësimin e materialeve apo pajisjeve të rrezikshmes me të parrezikshmen ose më pak të rrezikshmen;

- Sigurimin e të gjitha udhëzimeve dhe instruksioneve dhe rregulloreve përkatëse për shfrytëzimin e makinerive, pajisjeve e linjave teknologjike, të rregullave që duhen zbatuar për një punë të sigurtë dhe pa rrezik për shëndetin e të punësuarve;

Është e rëndësishme të theksojmë së në të katër linjat teknologjike, egzistojnë mundësi apo shkaqe që mund të çojnë në zhvillime të padëshiruara me pasoja të dëmtimit sigurisë dhe të shëndetit në punë. Rrisqet e mundëshme për të katër linjat teknologjike përshkruhen në vijim:

i. Mos zbatimi i grafikut të kontrolleve periodike mbi gjendjen teknike të pajisjeve në përgjithësi dhe të nyjeve të bashkimit të tyre në veçanti.
ii. Mos kryerja korrekte e shërbimeve teknike në nyjet bashkuese, mbrojtëset e sigurisë të pajisjeve lëvizëse, etj.
iii. Mos zbatimi korrekt i rregullave të shfrytëzimit të linjës teknologjike.
iv. Mungesë e furnizmit me energji elektrike, për periudha kohe të pacaktuara gjatë kohës së punës.
v. Mundësia e rënies së zjarreve.

Niveli i rriskut është relativisht i lartë nëse ndodhin zhvillimet e përshkruara në paragrafin paraardhës

a. Të gjitha zhvillimet e përshkruara në pikën **i** dhe **v**, bëjnë të mundur punën jo normale të pajisjeve gjatë punës së tyre.

Nga puna jo normale e pajisjeve rritet rrisku i ndërprerjes së pakontrolluar të shfrytëzimit të tyre si dhe rrisku i dëmtimit të shëndetit të punonjësve që i shfrytëzon ato.

b. Pafatësia teknike apo neglizhenca, janë dy faktorë që bëjnë të mos zbatohen rregullat e përcaktuara në shfrytëzimin e çdo linje teknologjike të instaluar këtu.

Këto shkelje mund të shoqërohen ose jo me prishje të nyjeve apo pajisjeve të veçanta të cilat nxjerrin nga puna të gjithë linjën, lejojnë bllokimin në to, të inerteve, plastikave, materiale drunore etj. që përpunohen, vështirësojnë shfrytëzimin normal të tyre, rrisin rrezikun e dëmtimit të personeli që i shfrytëzon ato, etj.

c. Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike, nuk sjell pasoja të drejpërdrejta në zhvillimet e proçeseve teknologjike.

Pasojat vijnë për shkak të ndërprerjes së ndriçimit në ambjentet e brendëshme ato të jashme të punës, gjë që vështirëson apo pengon, kryerjen e kontrolleve të plota mbi punën e pajisjeve të caktuara, të cilat mund të shkaktojnë rrjedhje të gazeve jashtë tyre.

d. Zjarret kanë shumë mundësi të ndodhin :

- ë vendet ku janë vendosur lëndët lehtësisht të djegëshme si dhe në ambjentet e punës në afërsi të impjantit të prodhimit të asfaltit, atij të magazinimit dhe përpunimit të lëndës drusore.
- për shkak të keq funksionimit të rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike, nga mbingarkesat, prishje të izolacioneve, tokzimeve, etj.

Rënia e zjarreve ndot mjedisin me produktet e djegies, nxehtësi duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastet ekstreme të eksplozioneve rreziku për shëndetin dhe jetën është shumë i madh.

II. Përshkrimi i masave për eleminimin, zvogëlimin dhe parandalimin e riskut të vlerësuar.

a. Është në detyrimin ligjor të administratorit apo përfaqsuesit ligjor të këtij subjektit, që medoemos duhet të lidhë marëdhënie pune me një subjekt juridik/fizik apo me një person i cili ka formimin profesional dhe eksperiencë punë të mjaftueshme për trajtimin e të gjitha problemeve që kanë të bëjnë me sigurinë në punë, gjatë shfrytëzmit të linjave teknologjike të instaluara këtu.

Ngirtja dhe funksionimi normal i kësaj strukture organizative/administrative do të bëjë të mundur të trajtojë në kohën e duhur çështje të tilla si:

- Rishikimin dhe plotësimet e mundëshme të rregulloreve të shfrytëzimit të linjave teknologjike dhe të rregulloreve të mbrojtjes në punë në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.
- Trajnimit e të gjithë punonjësve për kryerje me korrektesë dhe të sigurtë të punës së tyre në çdo vend pune vetjak. Trajnimet kryhen:
  - gjatë periudhës së punësimit, në mënyrë periodike;
  - në rast të risistemimit në një vend të ri të punës;
  - në rast të instalimit të teknologjisë së re ose mjeteve të reja për punë;
  - në rast të çdo ndryshimi të proçesit të punës, i cili mund ta ndryshojë nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Trajnimi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë përshtatet me specifikat e vendit të punës dhe realizohet në përputhje me rregulloret teknike dhe ato të mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes nga zjarri, të cilat azhornohet dhe ndryshohet në përputhje me ndryshimet respektive të legjislacionit, të teknologjive dhe pajisjeve si dhe të llojeve dhe formave të reja të rrezikut të vlerësuar.

- Kryerjen e kontrolleve dhe analizave të kohëpaskohshme të pajisjeve me rriskt të lartë, të mjedisit punës si dhe të përdorimit efikas të mjeteve individuale dhe atyre kolektive të mbrojtjes në punë.
- Mbatjen në gadishmëri të plotë teknike të pajisjeve të instaluara për shuarjen e zjarreve.
- Hartimin e planeve mbi organizimin dhe kryerjen e veprimeve që duhen ndërmarrë në rastet e rënies së zjarreve apo ndodhjes së aksidenteve në punë.
- Përcaktimn e vendqëndrimeve të sigurta, rrugëve më të sigurta të evakueimit në rastet e ndodhjes së aksidenteve apo rënies së zjarreve.

b. Po kështu duhet të lidhet një marëdhënie pune korrekte ligjore me një mjek të specializuar/liçensuar i cili duhet të ndjekë të mënyrë të vijueshme:

- Gjendjes shëndetësore të të punësuarve.
- Sigurimin e mjeteve të domosdodhme për dhënien e ndihmës së parë mjeksore në rastet e aksidenteve apo zjarre.
- Trajnimin e një apo dy punojnësve për dhënien e ndihmës së parë mjeksore.

a. Pajisja e punëtorëve me mjetet mbrojtëse persossnale si përshkruhet në vijim:

<u>Prodhimi i betonit dhe i elementëve prej betoni.</u>
Mjete dhe pajisje për mbrojtjen personale në punë, janë:

- Rroba pune prej doku.
- Syze për t'u mbrojtur nga pluhurat.
- Kufje për tu mbrojtur nga zhurmat.
- Këpucë.
- Doreza.
- Kapele minatori (plastike).

Mjete dhe pajisje për mbrojtjen kolektive në punë, do të përmendim, dy fikse zjarri me pluhur ABC, me vëllim 9 litra, që përdoren për fikjen e zjarrit në pajisjet elektrike.

<u>Reciklim i çfardo materiali, mbetje civile dhe industrial.</u>
Aktiviteti grumbullim, riciklim, përpunim lëndë të ndryshme (inerte, metale, plastikë, etj. është në përputhje të plotë me Direktiva e Këshillit 1999/31/EC e 26 Prillit 1999, pasi largon nga mbetjet urbane rreth 35 % të mbetjeve.

- Përpunimi i inerteve.
- Përpunimi i drurit.

- Përpunimi i plastikës.

Mjete dhe pajisje për mbrojtjen personale në punë, janë:

- Rroba pune prej doku.
- Syze për t'u mbrojtur nga pluhurat.
- Kufje për tu mbrojtur nga zhurmat.
- Këpucë.
- Doreza.
- Kapele minatori (plastike).

Mjete dhe pajisje për mbrojtjen kolektive në punë, do të përmendim, dy fikse zjarri me pluhur ABC, me vëllim 9 litra, që përdoren për fikjen e zjarrit në pajisjet elektrike dhe një fikse me shkumë me vëllim 50 litra.

III. Shkaqet e rënies së zjarreve dhe, masat mbrojtëse.

Djegia është një proçes teknologjik i cili përfaqson zhvillimin e proçesit të oksidimit me një shpejtësi të caktuar të lëndës djegëse, e kushtëzuar kjo, (shpejtësia) nga lloji i lëndës që digjet si dhe parametrat fizik të ambjentit ku zhvillohet proçesi.

Zhvillimi i proçesit të djegies shoqërohet me çlirim nxehtësie, drite dhe produkte djegie, tymra/gaze, hira, etj.

Si oksiduesi më i zakonshëm është oksigjeni.

Për lindjen dhe zhvillimin e proçesit të djegies/zjarrit duhet të plotësohen kushtet në vijim :

a) Prania e lëndës që digjet,
b) Prania e oksigjenit,
c) Burimi i nxehtësisë fillestare ose impulsi i nxehtësisë.

Plotësimi i kushteve për rënien e zjarreve, vjen për shkaqe apo mundësi të ndryshme, më të rëndësishmet prej të cilave po i tregojmë në vijim:

- Pakujdesia ;
- Ndezja e qëllimtë ;
- Vetëndezja e materieve;
- Shkarkimet elektrike
- Fërkimet mekanike,

Përgjithësisht lëndët djegëse të lëngëta dhe ato të gazta mbahen në enë të posaçme të mbyllura, pra të izoluara nga lëndë të jashme.

Në këtë veprimtari rënia e zjarreve është e mundur në vendet depozitimit të lëndës drusore, plastikave, pajsive të ndryshme elektrike etj.

Për të reduktuar efektet e dëmshme që shkakton zjarri, janë marë disa masa të tilla, siç janë:

- Realizimi i ndarjeve të sektorëve të punës dhe i rrugëve të lira për të garantuar në rast zjarri, largimin e personave në siguri të plotë si dhe, lëvizjen e mjeteve zjarrfikëse.
- Instalimin e pajisjeve të nevojshme për shuarjen e zjarrit.
- Masat e nevojshme për të sinjalizuar sa më shpejt rënien e zjarrit dhe për të siguruar aktivizimin e proçedurave të ndërhyrjes për shuarjen e tij.
- Sistemi i rrugëve të lira të lëvizjes sigurojnë mundësi të mëdha që punonjësit dhe persona të tjerë të rastësishëm, janë në gjendje t'i dallojnë qartësisht ato dhe t'i përdorin për të arritur në një vend të sigurtë edhe në mungesë të asistencës së jashtme.

Nëse ndryshohen kushtet e punës ose nëse shfaqet ndonjë rrezik i ri në një vend dhe mjedis të punës, për të cilët është hartuar ky dokument punëdhënësi/administratori medoemos duhet të përgatisë deklaratë/raport të ri për sigurinë në punë.

Raporti i sigurisë në vëndin e punës dhe në ambjentin e punës do të ndryshojë/plotësohet nëse konstatohet se:

1. Ndodhin dëmtime aksidente të rënda në vëndin e punës.
2. Masat ekzistuese që kemi marrë për të elemuniar, zvogëluar apo parandaluar riskun nuk duket të jenë shumë të përshtatëshme dhe efektive.

Ky raport sigurie në vëndin e punës dhe ambjentin e punës mund të ndryshohet edhe në bazë të masave të përcaktuara nga inspektoriati i punës, ai i mjedisit, i enëve nën presion etj.